



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2571/4 prot

Datë 17.11.2023

V E N D I M

Nr. 1183/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.11.2023 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78519-08-29-2023, me objekt: “Mirëmbajtje gjelbërim për 3 vite”, me fond limit 11.865.651 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 21.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave për ofertën e paraqitur nga BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK”.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK” në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78519-08-29-2023, me objekt: “Mirëmbajtje gjelbërim për 3 vite”, me fond limit 11.865.651 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 21.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe shtimin e arsyeve të

skualifikimit për ofertat e paraqitura nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës

Adresa: Lagjja 1, Rruga Tregtare, Durrës

Ankimues:

OE “A.M.E 2020” SHPK, me NIPT: K83725201G

Adresa: Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë.

BOE “LAND ART SHPK me NIPT: K11605501C & MALVIN SHPK me NIPT: J76403034Q”

Adresa: Godinë 2-katëshe, ish stacioni Zooteknik, Xhafzotaj, Durrës.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.08.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78519-08-29-2023, me objekt: “Mirëmbajtje gjelbërim për 3 vite”, me fond limit 11.865.651 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 21.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 04.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-----------------------|----------------------------------|
| 1. “A.M.E. 2020” SHPK | 10.798.041,60 lekë, skualifikuar |
| 2. “Land Art” SHPK | 11.271.553,80 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “A.M.E. 2020” SHPK rezulton i skualifikuar me argumentin si vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Operatori ekonomik nuk ka permbushur kriterin për të patur në stafin teknik një arkitekt peisazhi, diplomuar për këtë profil dhe që të punojë pranë kompanisë me kohë të plote dhe kontratë punë. OE ka paraqitur vetëm një kontratë bashkëpunimi me një arkitekt të diplomuar në UPT, shoqëruar me licencë për projektim peisazhi.”

II.3. Në datën 17.10.2023 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------------------|
| 1. “A.M.E. 2020” SHPK | 10.798.041,60 lekë, skualifikuar |
| 2. “Land Art” SHPK | 11.271.553,80 lekë, skualifikuar |

duke skualifikuar edhe operatorin ekonomik “Land Art” SHPK, me arsyetimin si vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Sipas pikës 2.3.9 të DST-ve operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka apo mund të vihen në dispozicion, të cilat nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira një autobot uji. OE ka vetëdeklaruar në formularin sipas shtojcës 9 si autobot uji mjetin me targë SH4785E. Gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar, u konstatua se, mjeti me targë SH4785E ka të bashkëngjitur leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik, policë siguracioni,

certifikatë regjistrimi në QKB dhe 2(dy) foto. Nga fotot vihet re se mjeti nuk është autobot uji dhe figuron në lejen e qarkullit me kodin B2. Sipas tabelës për format e karrocërve të mjeteve të transportit rrugor të miratuar nga DPSHTRR-ja në përputhje me Rregulloren e BE 2018/858, kodi B2 i korrespondon automjeteve për transport të përzier me karrocëri të hapur. Për rrjedhojë, rezulton se nga ana e operatorit ekonomik nuk plotësohen të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në vijim KVO vendosi të Skualifikojë BOE “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK”.

II.4. Në datën 18.10.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 23.10.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë shkresore ankesa me nr. 2571, protokolluar me datë 23.10.2023 e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78519-08-29-2023, me objekt: “Mirëmbajtje gjelbërim për 3 vite”, me fond limit 11.865.651 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 21.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK, kërkon mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për ofertën e paraqitur nga BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK”.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2571/2 prot, datë 24.10.2023.

II.5.2. Në datën 02.11.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2571/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Nr.3078/1 prot., datë 23.10.2023, me objekt: “Kthim përgjigje ankesës me nr. prot., 3078, datë 23.10.2023”, drejtuar shoqërisë ankimuese “A.M.E 2020” SHPK, për dijeni KPP-së. Referuar kësaj shkrese, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka pranuar asnjë nga pretendimet e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, duke e lënë atë të skualifikuar.

II.6. Në datën 23.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë shkresore ankesa me nr. 2573, protokolluar me datë 23.10.2023 e BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK” për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78519-08-29-2023, me objekt: “Mirëmbajtje gjelbërim për 3 vite”, me fond limit 11.865.651 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 21.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK”. Gjithashtu BOE “LAND ART

SHPK & MALVIN SHPK”, kërkon mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e paraqitur e nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2573/2 date 24.10.2023, me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ““LAND ART SHPK & MALVIN SHPK” si dhe kriteret të cilat BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK”, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, pjesmarrës në procedurë.

II.6.2. Në datën 02.11.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2573/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3080 prot., datë 23.10.2023 me objekt: “*Kthim përgjigje ankesës me nr. prot., 3080, datë 23.10.2023*”, drejtuar BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK”, për dijeni KPP-së. Referuar kësaj shkrese, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka pranuar asnjë nga pretendimet e BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK, duke e lënë atë të skualifikuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK se: “*Sipas pikës 2.3.9 të DST-ve operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka apo mund ti vihen në dispozicion, të cilat nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira një autobot uji. OE ka vetëdeklaruar në formularin sipas shtojcës 9 si autobot uji mjetin me targë SH4785E. Gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar, u konstatua se, mjeti me targë SH4785E ka të bashkëngjitur leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik, policë siguracioni, certifikatë regjistrimi në QKB dhe 2(dy) foto. Nga fotot vihet re se mjeti nuk është autobot uji dhe figuron në lejen e qarkullit me kodin B2. Sipas tabelës për format e karrocereve të mjeteve të transportit rrugor të miratuar nga DPSHTRR-ja në përputhje me Rregulloren e BE 2018/858, kodi B2 i korrespondon automjeteve për transport të përzier me karroceri të hapur. Për rrjedhojë, rezulton se nga ana e operatorit ekonomik nuk plotësohen të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në vijim KVO vendosi të skualifikojë BOE “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.9. e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar, përveç të tjerave, plotësimi i kriterit “autobot uji”, në pronësi ose me qira, si më poshtë vijon:

2.3.9. *Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në apo mund ti vihen në dispozicion, të cilat nevojiten për ekzekutimin e kontratës.*

Nr .	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
1.	Kamionçinë	ne pronësi ose me qera	cope 1
2.	Autovinc me kosh	ne pronësi ose me qera	cope 1
3.	<u>Autobo uji</u>	ne pronësi ose me qera	Cope 1
4.	Makineri korrese bari	ne pronësi ose me qera	4 cope
5.	Sharre universal per krasitje	ne pronësi ose me qera	4 cope

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Lejeqakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, leje transporti, foto dhe duhet të shoqerohet me kontraten përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi. Nëse mjetet janë të marra me qera, ofetuesi duhet të jetë i pajisur me licence transporti për të trete ose leje të transportit të jetë në emer të qeramarresit. Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira të paraqiten kontratë noteriale qiraje/huapërdorje me emër objekti dhe me afat të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve; dhe/ose kontratë noteriale qiraje/huapërdorje pa afat të përcaktuar.

Shënim: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9 të DST-ve.

III.1.2. Në shtojcën 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, gërma “a” e dokumenteve të tenderit është parashikuar shprehimisht:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

III.1.3. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, parashikohet si më poshtë vijon:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:

Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Profili i punonjësve
	Makineri e mjete
	Po [] Jo []
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Dokumenti “Akt - Marrëveshje” për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, me datë 21.09.2022, ndërmjet operatorëve ekonomikë “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK.

Në këtë akt - marrëveshje është rënë dakort ndarja e objektit të prokurimit si vijon:

➤ **27.2 %** Shoqëria “**LAND ART**”. sh.p.k. dhe

➤ **72.8 %** Shoqëria “**MALVIN**” sh.p.k.

Por te dy shoqëritë do të punojnë për realizimin e të gjitha punimeve sipas kontratës. Sejcili anëtar është dakort të përmbahet ofertës bashkarisht dhe veç e veç sejcili. Drejtimi i punimeve do të bëhet nga punonjësit dhe drejtuesit e shoqërive.

Shoqëria LAND ART kryej keto punime :

- B- TOTALI FURNIZIM VENDOSJE PER 3 VITE

Shoqëria MALVIN do të kryej keto punime:

- A- TOTALI MIREMBAJTJE PER 3 VITE

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) nga operatori ekonomik “Land Art” SHPK, ku në Deklaratën B për disponimin e makinerive të nevojshme është plotësuar si vijon:

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më v në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1.Kamioncine transporti	AB 896 FP	DRD00106822	WDB9061351N3 47018	Leje qarkullimi
2.Makine Korrese Bari cope 4	-	-	-	Fature tatimore
3.Sharr Universiale per krasitje cope 4	-	-	-	Fature Tatimore

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
-	-	-	-	-	-

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK, ku në Deklaratën B për disponimin e makinerive të nevojshme është deklaruar si vijon:

“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me v në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1.Autobot uji	SH 4785 E	SHF0655719	SFACXXBDVCLP1 6648	Leje qarkullimi
2.Makine Korrese Bari cope 4	-	-	-	Fature tatimore
3.Sharr Universiale per krasitje cope 4	-	-	-	Fature Tatimore
4.Autovinc me kosh	AA 109 VH	SHF0400215	ZCFC5980002025 780	Leje qarkullimi

Me qira	
---------	--

Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
-	-	-	-	-	-

III.1.6. Në ankesën e paraqitur nga shoqëria “Land Art” SHPK, anëtar i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK, pretendohet si vijon:

“[...] Në fazën e dorëzimit të dokumentacionit AK ka skualifikuar për mungëse të llojit të makinerisë përkatësisht autobot uji. Lidhur me këtë lloj makinerie të kërkuar nga AK, BOE ka paraqitur një lloj makinerie të llojit kamioncinë e cila së bashku me një depozitë kryen funksion të dedikuar si makineria e kërkuar. Për mjetin në fjalë është dorëzuar dhe fatura e blerjes së depozitës së ujit dhe të gjitha dokumentat e kërkuara (leje qarkullimi, taksa, kolaudim, nipt secundar, siguracion) gjithashtu dhe fotot e mjetit dhe fatura e depozitës së bashku me fotot. Bazuar në faktin që nga ana e AK nuk ka asnjë specifike në lidhje me autobotin e ujit, kapaciteti apo të dhena të tjera teknike, duke e lënë vlerësimin e operatorëve ekonomikë mbi përmbushjen e kriterit të mësipërm. [...] Nga ana jonë gjykojmë se në asnjë rast referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar shprehimisht llojin e mjetit që përcakton emërtimi autobot i ujit ndërkohë që DPSHTRR përcakton se automjetet për transport të vecantë janë cisternat ku përcaktohen dhe llojet e ndryshme të tyre. Por bazuar në llojin e shërbimit që do të prokurohet nga AK, jemi përpara faktit që kriteri i makinerisë autobot uji është vetëm për të siguruar transportin e ujit dhe jo faktin që kemi të bëjmë me rrezikshmëri. Nga ana jonë gjykojmë se në asnjë rast referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar shprehimisht llojin e mjetit që përcakton autoboti i ujit. BOE aktualisht kryen këtë shërbim me AK. Të gjithë kompanitë që merren me ofrimin e shërbimit që është objekt prokurimi në këtë procedurë, realizojnë shërbimin e ujitjes vaditjen përmes këtyre mjeteve nisur nga lloji i shërbimit. Shërbimi i mirëmbajtjes së gjelbërimit ka në vetvete një funksion të cilin e kryen me mjete që shërbejnë si autobot uji, bazuar në faktin që transporti i ujit nuk paraqet asnjë rrezikshmëri dhe nuk kërkon asnjë leje specifike për transport. Shërbimi i mirëmbajtjes së gjelbërimit përdor makineri të cilat i shërbejnë më mirë qëllimit të tij, nisur nga fakti që bimët, gjelbërimi kanë specifika të cilat kërkojnë që uji të përdoret në sasi dhe fuqi të caktuara për të mos sjellë dëmtime. Bazuar në faktin që automjeti që BO ka paraqitur, realizon më së miri shërbimin e kërkuar dhe është i lejueshëm si lloj transporti dhe si një operator me eksperiencë në fushën e kryerjes së këtij shërbimi nga ana jonë vlerësojmë se shërbimi që kryen autoboti i ujit që ne kemi paraqitur me dokumentet përkatëse është ekuivalent me autobotin e ujit të kërkuar nga ju. [...] Pra shërbimi që do të kryhet nga BO me këtë autobot (kamion+depo uji) e plotëson kriterin e kërkuar dhe e përmirëson në mënyrë cilësore.”

III.1.7. Në nenin 14, “Operatorët ekonomikë”, pika 2 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: “Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.”

III.1.8. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: 1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.9 Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.1.10. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji**. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të qarrantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.11. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.12. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,**

formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këtë rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;**
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.13. Në nenin 41, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.14. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i

tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit për autobot uji, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK kanë deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të shoqërisë “Malvin” SHPK se nga ana e këtij të fundit disponohet në pronësi autobot uji me targë SH4785E. Në fazën e vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor, mbështetur edhe në legjislacionin e prokurimit publik si më sipër cituar, e ka konsideruar kriterin të përmbushur, në përputhje me vetëdeklarimin e bërë nga BOE ankimues. Autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.** Pra në rastin konkret autoriteti kontraktor i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimues e plotëson këtë kriter. Nga ana e BOE, për automjetin në fjalë është paraqitur dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor, nga shqyrtimi i të cilit KVO ka gjykuar se nuk përmbushen kërkesat e autoritetit kontraktor për mjetin autobot, siç është bërë me dije edhe në njoftimin e skualifikimit, si më sipër cituar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se BOE ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës dhe konkretisht ka deklaruar mjetet në shtojcën përkatëse. Për mjetin “Autobot uji” është deklaruar në pronësi autobot uji me targë SH4785 E. Në ankesën e paraqitur në KPP ankimuesi ka dorëzuar foto të mjetit në fjalë i cili rezulton të jetë kamioncinë, fakt i cili pranohet edhe nga ankimuesi në ankesën e tij kur shprehet se: “BOE ka paraqitur një lloj makinerie të llojit kamioncinë e cila së bashku me një depozitë

kryen funksion të dedikuar si makineria e kërkuar. Për mjetin në fjalë është dorëzuar dhe fatura e blerjes së depozitës së ujit dhe të gjitha dokumentat e kërkuara (leje qarkullimi, taksa, kolaudim, nipt sekundar, siguracion) gjithashtu dhe fotot e mjetit dhe fatura e depozitës së bahku me fotot”. Në Komisionin e Prokurimit Publik, përveç doku metave të tjera, rezulton se ankimuesi ka paraqitur faturën tatimore me nr. 1102, datë 16.05.2018, për të cilën pretendohet se është fatura e blerjes së depozitës së ujit 1000 l.

Nga shqyrtimi i formularit të vetëdeklarimit të shoqërisë “Malvin” SHPK, pjesëtar i BOE “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK, nuk rezulton të jetë deklaruar fatura e blerjes së depozitës së ujit, krahas mjetit mbartës së depozitës, por është deklaruar vetëm mjeti bartës i depozitës, i cili faktikisht është “kamionçinë” dhe është konsideruar nga subjekti ofertues “Autobot”. Fatura e depozitës së ujit është paraqitur në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik pas hapjes së ofertave.

Lidhur me sa më sipër, KPP gjen me rast të sqarojë se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Paraqitja pranë autoriteteve kontraktore, apo pranë KPP-së, e dokumentacionit të kërkuar në DT, pas hapjes së ofertave, është i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur kemi të bëjmë me sqarime të cilat kërkojnë nga vetë autoriteti kontraktor në mbështetje rregullave të prokurimit publik. Në rastin konkret, nuk ndodhemi në këto kushte pasi autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumente e tenderit kërkesën për autobot uji, ndërkohë që ankimuesi ka deklaruar kamionçinë, siç e pranon vetë në ankesë, por nuk është deklaruar fatura e depozitës së ujit, pjesë e mjetit për plotësimin e kushtit të kërkuar si kapaciteti i ofertuesit për autobotin e ujit. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. KPP-ja nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri, i cili nuk është deklaruar në ofertë, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Në këtë rast dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në tender paraqet mangësi në përmbajtje dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Land Art” SHPK në lidhje me operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në parashikimin e nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohej shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët

e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.2.1. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.2.2. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë që Komisioni Prokurimit Publik pasi mori në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues vendosi lënien e tij të skualifikuar për shkak të shkeljeve të konstatuara në pikën III.1 të arsyetimit. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, pasi për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj se këto të fundit nuk qëndrojnë për shkaqet e cituara në pikën III.1 ndaj dhe për sa kohë që ankimuesi është skualifikuar dhe pretendimet e ngritura prej tij për ofertuesin “A.M.E 2020” SHPK nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës për shkak të shkeljeve të konstatuara në pikën III.1. të arsyetimit.

III.3. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3.5, të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE në datën 30.08.2023 rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.5. Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë ne stafin teknik te tij: 1 (një) Specialist për mbrojtjen e bimëve, 1 (një) Arkitekt peisazhi, që do të vërtetohet me paraqitjen e:

- *Kontratës së punes me kohë plotë, CV-së dhe diplomës përkatëse.*

III.3.2. Në shtojcën 9 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, Pjesa III *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, gërma “B” DEKLARATË: Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetëdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash

III.3.3. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, gërma “a”, e dokumenteve të tenderit, është parashikuar shprehimisht:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

III.3.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9), të plotësuar prej tij, ku në Deklaratën për disponimin e punonjësve është deklaruar si vijon:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve mesatarisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës per periudhën e kërkuar ne DT Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Agim Kajmaku, me profesion Menaxher, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Menaxherit, si dhe specialist i certifikuar per sherbime gjelberimi/lulishtar etj. Artir Dunga, me profesion Lulishtar, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Lulishtar, si dhe specialist i certifikuar per sherbime gjelberimi. Orges Metaliu, me profesion Lulishtar, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Lulishtar, si dhe specialist i certifikuar per sherbime gjelberimi.

	Arjeta Dybelli, me profesion Lulishtar, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Lulishtar, si dhe specialist i certifikuar per sherbime gjelberimi, dhe Specialiste e certifikuar per vaditje. Sami Vrana, me profesion Lulishtar, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Lulishtar, si dhe specialist i certifikuar per sherbime gjelberimi, dhe Specialist i certifikuar per vaditje. Hysni Korriku, me profesion Lulishtar, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Lulishtar, si dhe specialist i certifikuar per sherbime gjelberimi, dhe Specialiste e certifikuar per Punime ne Lartesi. Merita Kajmaku me profesion Inxhinieri Pyjesh, Profili Hortikulture dhe Mbrotje Bimesh, punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Administratore, si dhe specialist i certifikuar per sherbime gjelberimi. Adrian Muça me profesion Agronom i Larte, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e <u>Agronomit te Larte, dhe eshte gjithashtu Specialist per Mbrojtjen e Bimeve.</u> Masilda (Sinani) Heqimaj, Arkitekte Peizazhi, me diplome dhe Licence Profesionale ne Projektim Peizazhesh. Marjus Heqimaj, Inxhinier Mjedisi dhe Ekspert Mjedisi, Eksper per hartimin dhe vleresimin e raporteve per ndikimin ne mjedis. Disponimin e punonjesve te kerkuar e plotesojme me dokumentacion perkates, listepagesa, vertetim kontributesh, diploma, certifikime, kontrata pune, dhe/ose deshmi sipas percaktimeve ne DT ne rast se shpallemi fitues i vendosim ne dispozicion te AK per realizimin e objektit te prokurimit konform LPP dhe nenit 26/6 te VKM nr 285/2021. Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr. 285 datë
--	---

III.3.5. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.3.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. **Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të qarrantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

III.3.7. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.3.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin,

si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërket të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.3.9. Në nenin 41, pika 2 dhe 4 gërma “b” dhe “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose [...]”

III.3.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa**

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: h) **operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);** 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimes në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës. Konkretisht ka deklaruar personelin dhe stafin teknik për kryerjen e shërbimit sipas përcaktimeve të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit si më sipër cituar. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Gjithashtu, nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën h) *operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti)*, për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimes nuk e plotëson këtë kriter.

Gjithashtu, sipas shtojcës 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklarata do të bëhen *në rastet kur janë të zbatueshme*: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit,

duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik “A.M.E” SHPK qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “A.M.E” SHPK, për sa i përket BOE “Land Art” SHPK dhe “MALVIN” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se ky i fundit mbetet i skualifikuar, bazuar në konstatimet e këtij Komisioni dhe trajtuar hollësisht në pikën III.1 të arsyetimit, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78519-08-29-2023, me objekt: “Mirëmbajtje gjelbërim për 3 vite”, me fond limit 11.865.651 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 21.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “LAND ART SHPK & MALVIN SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri